

TURIZMI NË PRIZREN

TURIZMI NË PRIZREN


Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Adresa: Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 nr.5,
10000 Prishtinë

Kontakti: www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Sida-s.



HYRJE

Duke pasur parasysh potencialin turistik të Kosovës falë pasurive natyrore dhe kulturore sektori i turizmit mund të konsiderohet si një nga burimet potenciale kryesore të zhvillimit ekonomik në vend. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës numri i vizitorëve (vendor dhe të jashtëm) në Kosovë gjithsej gjatë vitit 2020 ishte 151816 vizitorë derisa tre qytetet kryesore që tërheqin më së shumti vizitorë janë Prishtina, Peja dhe Prizreni.¹

Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 627 km² (5.94 % e territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës me 76 vendbanime dhe me 177781 banorë. Kufizohet me Komunitatet e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpçës dhe Dragashit si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë.² Meqenëse Komuna e Prizrenit konsiderohet si një ndër vendbanimet kryesore të turizmit dhe potencialin gjithashtu janë hartuar edhe politika dhe ligje nga ana e institucioneve lokale dhe qendrore si: Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2019 - 2023³, Plani i Menaxhimit për Zonën Historike të Prizrenit 2019 - 2028⁴, Ligji për Zonën Historike të Prizrenit⁵ me synim të zhvillimit të potencialit dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë komunë.

Me qëllim të vlerësimit të gjendjes së turizmit në Prizren nga këndvështrimi i turistëve, EC së bashku me Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren ka realizuar këtë hulumtim në formë të anketave me turistë të jashtëm dhe ata nga rajonet e Kosovës.

Anketa është realizuar me 151 pjesëmarrës/e nga të cilët 26.5 % përkatësisht 40 pjesëmarrës/e përbënin grupin **18-24 vjeç**, 37.7 % përkatësisht 57 pjesëmarrës/e përbënin grupin **25-34 vjeç**, 17.2% përkatësisht 26 pjesëmarrës/e përbënin grupin **35-44 vjeç**, 10.6 % përkatësisht 16 pjesëmarrës/e përbënin grupin **45-54 vjeç**, 6.0 % përkatësisht 9 pjesëmarrës/e përbënin grupin **55-64 vjeç** dhe 2.0 % përkatësisht 3 pjesëmarrës/e përbënin grupin mbi **65 vjeç**.

Sa i përket raportit gjinor proporcioni ishte 56.3% përkatësisht 85 pjesëmarrës ishin **burra** ndërsa 43.7 % përkatësisht 66 pjesëmarrëse ishin **gra**.

Nga pjesëmarrësit/et 27.2 % përkatësisht 41 persona janë deklaruar me status **studenti**, 60.9 % përkatësisht 92 persona janë deklaruar **të punësuar**, 7.9 % përkatësisht 12 persona janë deklaruar **të papunë** ndërsa 4 % përkatësisht 6 persona janë deklaruar **të pensionuar**.

1 Statistikat e Hotelarisë TM2 2021:

<https://ask.rks-gov.net/media/6268/statistikat-e-hoteleris%C3%AB-tm2-2021.pdf>

2 Web-faqja e Komunës së Prizrenit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/qyteti/siperfaqja>

3 Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2019 - 2023:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2019/03/Draft-Strategjia-per-Zhvillimin-e-Turizmit-Komuna-e-Prizrenit_2019-2023.pdf


4 Plani i Menaxhimit për Zonën Historike të Prizrenit 2019 - 2028:

<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-07-47-30052019/Plani%20i%20menaxhimit%20per%20QHP.pdfw>


5 Ligji Nr. 04/L-066 për Zonën Historike të Prizrenit:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2836>


Në cilin shtet jetoni?




A jeni pjesë e diasporës?



A është kjo vizita juaj e parë në Prizren?




Sa do të qëndroni?



Cila është arsyeja e vizitës tuaj?




Çka do të vizitoni gjatë qëndrimit tuaj në Prizren?




Nga ajo çka keni parë deri më tani, çka ju ka pëlqyer më së shumti në Prizren?




Sa jeni të kënaqur me cilësinë e shërbimeve të ofruara deri më tani?




A mendoni se vendet që keni vizituar ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara?




Si e vlerësoni pastërtinë në qytet?




A mendoni se ka gjelbërim të mjaftueshëm në qytet?



A mendoni se tarifat/çmimet e parkingjeve janë reale?




A mendoni se tarifat/çmimet e taksive janë reale?




Sa jeni të kënaqur me:


MIKPRITJEN E BANORËVE LOKAL




AKOMODIMIN



SHËRBIMIN E PERSONELIT TË HOTELIT




USHQIMIN




Sa jeni të kënaqur me:


QASJEN NË MONUMENTET KULTURORE DHE FETARE




INFORMACIONIN E PRANUAR NË MONUMENTET KULTURORE DHE FETARE



SHENJËZIMIN/ORIENTIMIN NË QYTET




SHËRBIMET E OFRUARA NGA INSTITUCIONET KOMUNALE




Sa jeni të kënaqur me:


ÇMIMET/KOSTON E SHËRBIMEVE TË PRANUARA




SIGURINË




A i ka përmbushur Prizreni pritjet tuaja?



A do ta vizitoni përsëri Prizrenin?



A do të ju rekomandoni familjarëve/shoqërisë ta vizitojnë Prizrenin?



PËRFUNDIME

Në vijim mund të gjeni të dhënat dhe statistikat e dala nga anketat e realizuara me turistët:

- Pyetësi është realizuar me turistë vendor nga qytetet tjera të Kosovës dhe ata të jashtëm. Nga pjesëmarrësit/et 23.84% përkatësisht 36 persona janë deklaruar se jetojnë në Gjermani, 12.58% përkatësisht 19 persona janë deklaruar se jetojnë në Kosovë, 10.6% përkatësisht 16 persona janë deklaruar se jetojnë në Zvicër, 8.61% përkatësisht 13 persona janë deklaruar se jetojnë në Shqipëri, 6.62% përkatësisht 10 persona janë deklaruar se jetojnë në SHBA dhe kështu me radhë.
- Në pyetjen e parashtruar pjesëmarrësit/et kanë thënë se 58.9% përkatësisht 89 persona se Po, janë pjesë e diasporës ndërsa 41.1% përkatësisht 62 persona Jo, nuk janë pjesë e diasporës.
- Shumica dërmuese e pjesëmarrës/eve kanë thënë se nuk është vizita e parë e tyre në qytetin e Prizrenit me 76.8% përkatësisht 116 persona, ndërsa 23.2% përkatësisht 35 persona janë deklaruar se kjo është hera e parë që e vizitojnë qytetin e Prizrenit.
- Shumica e të anketuarve e kanë përzgjedhur si arsye primare të vizitës në qytetin e Prizrenit turizmin kulturor (festivalet, monumentet kulturore) dhe vizitat në familje/miq me 31.0% përkatësisht 33.9% duke vazhduar me 16.9% që kanë përzgjedhur opcionin vizitë vendlindjes, 10.2% që kanë përzgjedhur opcionin turizëm natyror/malor dhe 3.3% e të anketuarve që kanë cekur se kanë ardhur në Prizren për arsye biznesi. Poashtu vlen të ceket se 4.5% e pjesëmarrësve/eve kanë potencuar specifikisht se kanë ardhur në Prizren për arsye tjera sikur vizita e qendrave tregtare dhe pjesëmarrje në ahengje familjare.
- Sa i përket kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre pothuajse gjysma e të anketuarve (47% përkatësisht 71 persona) kanë cekur se do të qëndrojnë në Prizren më shumë se 5 netë, 23.2% përkatësisht 35 persona kanë potencuar se do të qëndrojnë vetëm disa orë, 16.6% përkatësisht 25 persona kanë cekur se do të qëndrojnë në një interval kohor 3 – 5 netë dhe 13.2% përkatësisht 20 persona që potencuan se planifikojnë të qëndrojnë 1 – 2 netë në qytetin e Prizrenit.
- Në përgjigjet e tyre pjesëmarrësit/et kryesisht kanë potencuar se planifikojnë t'i vizitojnë restaurantet/baret me 19.5%, monumentet kulturore dhe fetare me 17.8% (ku vlen të ceket se pjesëmarrësit/et që kanë përzgjedhur këtë opcion kryesisht kanë potencuar se planifikojnë të vizitojnë Kalanë e Prizrenit dhe Muzeun e Lidhjes së Prizrenit) dhe familjarët/miq me 17.8% poashtu. Alternativat tjera të përzgjedhura janë: dyqanet/qendrat tregtare me 16.1%, festivalet me 15%, vizitë

në natyrë me 12.8% dhe një numër i vogël i pjesëmarrësve prej 1.1% që kanë përzgjedhur opcionin tjetër duke potencuar se planifikojnë të vizitojnë edhe alternativa tjera sikur pishinat.

- Nga përvojat e tyre gjatë qëndrimit në Prizren pjesëmarrësit/et kanë potencuar se më së shumti u kanë pëlqyer monumentet kulturore dhe fetare me 27.4% (ku pothuajse gjysma e kanë shënuar Kalanë e Prizrenit, duke vazhduar me Muzeun e Lidhjes së Prizrenit, xhamitë, kishat dhe objektet tjera në qendrën historike), alternativën festivalet me 18.6%, vizitat në natyrë me 17.0%, restaurantet/baret me 16.7%, dyqanet/qendrat tregtare me 14.8% dhe së fundi opcionin tjetër ku kanë cekur se ju ka pëlqyer arkitektura e qytetit dhe mikpritja kryesisht.
- Nga 151 pjesëmarrës/e, 73.5% apo 111 prej tyre janë deklaruar që janë shumë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve të ofruara në Prizren gjatë qëndrimit të tyre, përderisa 24.5% e të anketuarve apo 37 persona janë deklaruar se janë deri diku të kënaqur, kurse vetëm 3 persona përkatësisht 2.0% janë deklaruar se janë pak dhe aspak të kënaqur.
- Vlerësimi i më shumë se gjysmës së pjesëmarrësve/eve (60.9% përkatësisht 92 persona ishte i mirë nëndërkohë që 19.9% përkatësisht 30 pjesëmarrës/e e kanë vlerësuar nivelin e pastërtisë si shumë të mirë. Poashtu 16.6% përkatësisht 25 persona e kanë vlerësuar nivelin e pastërtisë keq dhe 2.6% përkatësisht 4 persona e kanë vlerësuar si shumë të keq duke potencuar sasinë e lartë të mbeturinave në hapësirat publike dhe në Lumbardh si dhe mungesën e shportave të mbeturinave si arsye kryesore.
- Gjysma e pjesëmarrësve kanë shprehur mendimin se ka deri diku gjelbërim të mjaftueshëm sipas observimeve të tyre në qytetin e Prizrenit. 28.2% e pjesëmarrësve janë potencuar se po ka gjelbërim të mjaftueshëm ndërsa me opcionin jo janë deklaruar 20.8% e pjesëmarrësve ku kryesisht janë ankuar edhe për mungesën e mirëmbatjes së hapësirave të tilla.
- Përderisa 40% e pjesëmarrësve mendojnë se vendet që kanë vizituar gjatë qëndrimit të tyre në Prizren nuk ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara. Poashtu 36.1% kanë theksuar se vendet e vizituara nga ata ofrojnë deri diku ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa 23.8% e të anketuarve janë deklaruar se sipas tyre po ofrohet qasje për personat me aftësi të kufizuara. Disa prej arsyeve kryesore të potencuara, të mungesës së qasjes për personat me aftësi të kufizuara të cilat i kanë identifikuar të anketuarit janë: trafiku, rrugët me gjerësi dhe materializim të papërshtatshëm, mungesa e pjerrinave, mungesa e shenjzimit, trotualet e uzurpuara etj.

- Nga pjesëmarrësit 37.5% e tyre vlerësojnë se çmimet e parkingjeve jo nuk janë reale sipas tyre. Poashtu me vlerësimin deri diku janë përgjigjur 28.2% e tyre, ndërsa me po janë përgjigjur 34.5%.
- Në pyetjen se a janë reale tarifatat/çmimet e taksive, të anketuarit kanë vlerësuar se ato janë deri diku reale me 37.8%, po janë reale me 34.1% dhe me jo me 28.0%.
- Në aspektin e sigurisë të 69.8% e të anketuarve janë përgjigjur se janë shumë të kënaqur me sigurinë në qytet, përderisa 25.5% të tyre janë deri diku të kënaqur, kurse rreth 4.7% të tyre janë pak ose aspak të kënaqur
- Shumica dërmuese e pjesëmarrës/eve janë shumë të kënaqur me mikpritjen e banorëve lokal në Prizren, përkatësisht 86.0%, përderisa rreth 12.7% e vlerësojnë deri diku mikpritjen, kurse nga 0.7% të anketuarve janë pak ose aspak të kënaqur me mikpritjen e banorëve lokal.
- Në aspektin e shenjzimit dhe orientimit në qytet, të anketuarit janë më pak të kënaqur. Nga të anketuarit rreth 27.4% janë deklaruar shumë të kënaqur, kurse 46.6% janë deklaruar deri diku të kënaqur. Ndërsa rreth 19.2% janë pak të kënaqur dhe rreth 6.8% janë aspak të kënaqur.
- Sa i përket qasjes në monumente kulturore dhe fetare 68% e pjesëmarrësve kanë vlerësuar se janë shumë të kënaqur, 27% janë ndarë deri diku të kënaqur dhe 5% e tyre kanë vlerësuar se janë pak dhe aspak të kënaqur.
- Lidhur me informacionet që i kanë pranuar në monumentet kulturore dhe fetare gjatë vizitës së tyre pothuajse gjysma e të anketuarve me 47.8% janë deklaruar se janë shumë të kënaqur derisa 33% janë deklaruar se janë deri diku të kënaqur. Me opcionin pak janë deklaruar 12.2% derisa aspak nuk janë të kënaqur kanë thënë 7% e pjesëmarrësve.
- Shumica dërmuese e të anketuarve me 75.7% janë deklaruar se janë shumë të kënaqur me kushtet e akomodimit gjatë qëndrimit të tyre. Nëndërkohë me opcionin deri diku janë deklaruar 15.7%, opcionin pak 7.1% dhe opcionin aspak 1.4%.
- Me shërbimin e personelit të hotelit poashtu janë ndarë shumë të kënaqur një numër i madh i pjesëmarrësve me 79% derisa 16% kanë potencuar se janë deri diku të kënaqur, 4% janë pak të kënaqur dhe me 1% aspak të kënaqur.
- Poashtu sa i përket ushqimit 84.9% e pjesëmarrësve janë deklaruar se janë shumë të kënaqur, 13.7% janë deklaruar se janë deri diku të kënaqur, dhe 0.7% janë deklaruar se janë pak përkatësisht aspak të kënaqur.

- Vlerësimi i pjesëmarrësve për çmimet/kostot e shërbimeve të pranuar përgjithësisht është se janë shumë të kënaqur me 61.6% dhe deri diku të kënaqur me 31.1% derisa me pak përkatësisht aspak janë deklaruar 6.6% përkatësisht 0.7% e të anketuarve.
- Nga pjesëmarrësit ata të cilët kanë pasur nevojë të shfrytëzojnë shërbimet e ofruara nga institucionet komunale kanë pasur vlerësimin e tillë: janë ndarë shumë të kënaqur me 40.3%, deri diku të kënaqur me 43.1%, pak të kënaqur me 9.7% dhe aspak të kënaqur me 6.9%.
- Sipas përgjigjeve të marra nga të anketuarit qyteti i Prizrenit i ka përmbushur pritjet e tyre. Numri më i madh i të anketuarve ose 82.1% përkatësisht 124 pjesëmarrës janë deklaruar pozitivisht, përderisa për rreth 16.6% përkatësisht 25 pjesëmarrës i ka përmbushur deri diku pritjet e tyre, kurse 1.3% përkatësisht 2 pjesëmarrës janë përgjigjur negativisht.
- Për shumicën dërrmuese të të anketuarve Prizreni do të jetë destinacion vizite përsëri. Rreth 93.4% përkatësisht 141 persona janë përgjigjur se po do ta vizitojnë Prizrenin, ndërsa rreth 6.6% përkatësisht 10 persona janë deklaruar se ndoshta do ta vizitojnë përsëri Prizrenin. Vlen të ceket poashtu se asnjë nga pjesëmarrësit nuk janë deklaruar me jo se nuk do ta vizitojnë përsëri qytetin.
- Nga 151 pjesëmarrës/e në pyetësor, 150 prej tyre ose 99.3% janë deklaruar pozitivisht se do ta rekomandojnë vizitën në Prizren tek të afërmit/shoqëria e tyre, kurse vetëm një pjesëmarrës përkatësisht 0.7% është përgjigjur negativisht.

Rekomandime

- Turizmi kulturor është vlerësuar si një nga arsyet primare që ka inkurajuar turistët që të vizitojnë qytetin e Prizrenit prandaj rekomandohet që institucionet lokale dhe qendrore të përkushtohen në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në objektet e trashëgimisë kulturore për tu mundësuar qasje më e lehtë.
- Përpos pothuajse gjysmës së pjesëmarrësve në hulumtim që janë deklaruar se do të qëndrojnë në Prizren për më shumë se 5 ditë, rreth ¼ e tyre janë deklaruar se do të qëndrojnë vetëm për disa orë. Rekomandohet që institucionet lokale dhe qendrore të hartojnë politika dhe strategji në dobi të ngritjes së interesimit për të shpenzuar më shumë kohë në vend.
- Nivelet e ndotjes në rrjedhën e lumit Lumbardh dhe në hapësirat publike në Qendrën Historike të Prizrenit kanë qenë një ndër shqetësimet e potencuara nga turistët. Turizmi i bazuar në hapësirat natyrore do të vazhdojë të tërheqë vizitorë të çdo lloji, arsye pse ato duhet të mirëmbahen dhe të dizajnohen duke marrë parasysh nevojat e gjithsecilit, duke i vendosur njeriun dhe parimet universale të dizajnit në thelbin e të gjitha produkteve dhe shërbimeve turistike të bazuara në natyrë.
- Duke pasur parasysh që shumica e të anketuarve kanë observuar mungesën e hapësirave adekuate për qarkullimin dhe shfrytëzim nga ana e personave me aftësi të kufizuara rekomandohet që institucionet lokale dhe qendrore të përkushtohen në përmirësimin e kushteve të mobilitetit për këtë grup. Meqenëse turizmi është e drejtë themelore shoqërore për të gjithë zhvillimi i infrastrukturës me bazë gjithëpërfshirjen duhet të konsiderohet prioritare.
- Pjesëmarrësit në hulumtim poashtu kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me tarifat joreale të parkingjeve dhe shërbimeve të taksive gjatë vizitës së tyre prandaj rekomandohet që institucionet lokale dhe qendrore të shtojnë inspektimet e tyre në terren për verifikime të keqpërdorimeve potenciale. Gjithashtu rekomandohet dhe përmirësimi i shërbimit të transportit publik në vend.
- Proceset e ndërlydhura siç janë hartimi i politikave dhe planifikimi i infrastrukturës gjithëpërfshirëse, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, zhvillimi i transportit publik, zhvillimi i burimeve njerëzore, promovimi etj, sigurisht se mund të shtojnë potencialin dhe vlerën turistike të qytetit të Prizrenit prandaj rekomandohet që hapat e ndërmarra të jenë në përputhje me Planin e Menaxhimit për Zonën Historike të Prizrenit, Planin e Konservimit, Ligjin për Zonën Historike të Prizrenit dhe Planin Zhvillimor Komunal.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente: **1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e komprometuar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe

4. Komuniteti bazë e veprimi - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.